



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 88 prot.

Kamëz, më 20.11.2025

V E N D I M
Nr. 82 .Datë 20/11 2025
M B I

**“MIRATIMIN E FAMILJES PËRFITUESE NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT
“BANESA SOCIALE ME QIRA” TË APARTAMENTIT TË PËRFITUAR NGA
KONTRIBUTI I SEKTORIT PRIVAT”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.77 Datë 14.11.2025 në mbështetje Ligji Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligji nr 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligji nr 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; nenet 801-823 të ligjit nr 7850 datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil në republikën e Shqipërisë", VKM nr. 384 datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM Nr. 522 Datë 25.07.2019 "Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira"; VKM 518 datë 04.09.2018 "Për Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën shumë për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të e organizuar" VKM nr.301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit si dhe kushtet e standartet për banesat sociale që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët; Udhëzimi nr. 1 datë 10.09.2025 "Për Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2025 ; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak "Për ngritjen e Komisionit të Strehimit"; VKB nr 119 dt.19.12.2024 për "Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2025, 2026, 2027"; VKB nr 59 dt.25.08.2025 "Për miratimin e rregullores për administrimin e banesave sociale" Relacionit të Komisionit të Strehimit me nr. Prot 9967 datë 12.11.2025; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e familjes përfituese së z. [REDAKTUAR], nga programi social i strehimit "**Banese Sociale me Qira**", për hyrjen në apartamentin me nr. pasurie 90/124+1-4, zonë kadastrale nr. 2066 me sipërfaqe 100.4 m² të përfituar nga kontributi i sektorit privat në fondin publik të banesave sociale, sipas Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij projekt-vendimi.
2. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

